

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore të paditësit E.D.C. me seli në P.,ndaj të të paditurës N.P.Q L. sh.p.k me seli në P. (në prani të të autorizuarës me shkrim të palës paditëse avokates I.O.-S. nga P. dhe të të autorizuarit me shkrim të palës së paditur avokatit M.N. nga P.),lidhur me pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej;25,125.04 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes të datës;24.05.2018,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare nga palët ndërgjyqëse,me datën;04.06.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.D.C. me seli në P..

I.Detyrohet pala e paditur N.P.Q L. sh.p.k me seli në P. që ti paguaj palës paditëse E.D.C. me seli në P.,shumën e përgjithshme prej;25.125,04 (njëzetë e pesë mijë e njëqind e njëzetë e pesë euro e katër cent) euro në emër borxhit kryesor lidhur me dislokimin e garazhës K.,me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës në periudhë kohore prej një viti pa destinim të caktuar duke filluar nga data 20.11.2008 e deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve,nga dita e pranimit ë këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.Detyrohet pala e paditur N.P.Q L. me seli në P.,që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ti paguaj palës paditëse shumën e përgjithshme prej;3,372.80 euro,në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi E.D.C. me seli në P.,me datën;20.11.2008 ka parashtruar pranë kësaj gjykate padinë e tij lidhur me pagesën e borxhit kryesor në shumën e përgjithshme prej 23.629,59 euro,me kamatë ligjore duke filluar nga data 21.08.2008 e deri në pagesën definitive të borxhit,ndaj palës së paditur NPQ L. sh.p.k me seli në P.,duke kërkuar nga gjykata që pas administrimit të të gjitha provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Lënda është kthyer në rivendosje në këtë gjykatë nga Gjykata e Apelit të Kosovës përmes aktvendimit të saj që mbanë evidencë Ae.nr.315/2017 të datës;28.03.2018 me sygjerimin e saj të dhënë se nuk është vërtetuar gjendja e plotë faktike mbi mosvërtetimin e vlefshmërisë së provave konstatuese,poashtu gjykata duhet të përcaktoj mbi cilin dispozitë materiale ka aprovuar kërkesat e palëve,si dhe me rastin e vendosjes mbi kundërpadinë nuk ka sqaruar kundërpadinë kompensuese.

Pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse gjykata i ka ftuar të njëjtit nëse kanë prova tjera shtesë apo propozime eventuale lidhur me këtë çështje juridike kontestimore,mirëpo të njëjtit kanë deklaruar se përveq thënjeve të cituara më lartë nuk kanë tjetër për të shtuar,andaj gjykata duke vepruar konform nenit 420 paragrafi 3 të LPK-së ka kaluar nga seanca përgatitore në seancën kryesore të çështjes.

E autorizuar e palës paditëse në seanca e shqyrtimit përgatitor, e poashtu edhe në fjalën e saj përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë së paditësit duke kërkuar nga gjykata aprovimin e saj në tërësi si të bazuar pas administrimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e njëjta i ka propozuar gjykatës aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit lidhur me dislokimin e garazhës K. duke u bazuar në nenin 3 të Deklaratës për Shkëputjen e Ortakërisë, ndërsa lartësia e borxhit të kërkuar nga pala paditëse është vërtetuar përmes ekspertizës së hartuar eksperti financiar R.B. dhe nga grupi i ekspertëve financiar; A.G. Sh.J. dhe Sh.B., ndërsa sa i përket ofertave të prezantuara nga pala e paditur që kanë dhënë M.C. dhe BMS I. ato asnjëherë nuk i janë ofruar palës paditëse, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtat të mos shqyrtohen, e poashtu edhe ekspertiza e ndërtimtarisë e hartuar nga eksperti N.M. e cila ka qenë me mangësi të dukshme të mos mirret si provë me fuqi provuese, andaj përfundimisht i ka propozuar gjykatës aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit si të bazuar.

Ndërsa lidhur me kundërpadinë e palës N.P.Q Lesna i ka propozuar gjykatës që e njëjta të mos përfshihet në dispozitivin e këtij aktgjykimi për faktin se kjo është çështje e gjykuar sepse me rastin e refuzimit sipas aktgjykimit që mbanë evidencë C.nr.149/2009 të datës; 10.09.2009 të marrë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë dhe ndaj të njëjtit pala e paditur nuk kishte ushtruar ankesë, andaj si e tillë as që është përmendur në seancat e mbajtura nga pala e paditur.

E autorizuar e palës paditëse ka specifikuar shpenzimet e procedurës kontestimore në fjalën e saj përfundimtare.

I autorizuari i palës së paditur si në seancën përgatitore, e poashtu edhe në fjalën e tij përfundimtare ka kundërshtuar pretendimet e palës paditëse duke i propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë në tërësi si të pabazuar. Kundërshtimet e tija pala e paditur i bazon në pretendimin e tij se edhe përkundër propozimit të tij për formimin e një komisioni të përbashkët për të bërë dislokimin e garazhës K. pala paditëse ka njohtuar palën e paditur se ka bërë dislokimin e kësaj garazhe duke shpenzuar shumën e përgjithshme prej; 47.259,19 euro duke kërkuar nga pala e paditur detyrimin e saj në shumë prej; 23.629,59 euro, andaj pala e paditur duke u thirrur në deklarin e tij se vetëm 5 nga 39 faturat e prezantuara nga pala paditëse kanë përshkrimin e garazhës K., ndërsa faturat tjera nuk e kanë këtë përshkrim i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e palës paditëse të refuzohet në tërësi si e pabazuar,

Përfundimisht në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim i autorizuari i palës së paditur ka kundërshtuar ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti R.B. si dhe ekspertizën e hartuar nga grupi i ekspertëve; A.G., Sh.J. dhe Sh.B., ndërsa i ka propozuar gjykatës që besimin t'ia fal ekspertizës së hartuar nga eksperti i ndërtimtarisë N.M..

I autorizuari i palës së paditur i ka kërkuar dhe ka specifikuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në procedurën e provave e autorizuar e palës paditëse ka mbetur pranë pretendimit që janë të njohura për atë të gjitha shkresat të cilat gjinden në lëndët që evidentohen me shenjën C.nr.149/2009 dhe C.nr.437/2014,ndërsa i autorizuari i palës së paditur ka propozuar që të administrohen si prova edhe shkresat të cilat i janë bashkëngjitur parashtresës së datës;06.11.2017.

Gjykata me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së palës paditëse e ka bazuar paraprakisht në dispozitën e nenit 3 të Deklaratës për shkëputjen e Ortakërisë së datës;23.04.2007 nga e cila dispozitë rezulton se palët kanë detyrim prej 50% secila veç e veç që ti mbulojnë shpenzimet financiare të dislokimit të garazhës K. pronë e I.A..Lartësinë e detyrimit lidhur me shpenzimet e dislokimit të garazhës K. janë precizuar me ekspertizën financiare të ekspertëve A.G.,Sh.J. dhe Sh.B. të datës;30.05.2017 dhe ekspertit financiar R.B. në ekspertizën e tij të hartuar me shkrim të datës;20.10.2015 dhe plotësimin të saj të datës;16.01.2017, andaj bazuar në të cekuar më lartë gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 262 të LMD-së e cila në mënyrë shprehimore përcakton se “kreditoret në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”, andaj edhe e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit E.D.C. me seli në P.,ndërkohë që ka aprovuar edhe propozimin e palës paditëse që konsiston në trajtimin e kundërpadisë së ushtruar nga N.P.Q L. si çështje e gjykuar,pasiqë e njëjta është refuzuar si e pabazuar sipas aktgjykimit që mbanë evidencë C.nr.149/2009 të datës;10.09.2009 dhe ndaj këtij aktgjykimi pala e paditur nuk kishte ushtruar ankesë.

Lidhur me detyrimin e pagesës në afatin prej 7 (shtatë) ditëve që ka të bëjë me afatin paritiv është bazuar në dispozitat e nenit 509 pika e të LPK-së,ndërsa lidhur me kamatën ligjore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 277 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së,duke i aprovuar shumën e përgjithshme prej 3,372.80 euro prej të cilave shumën prej;2,894.04 euro sipas aktgjykimi që mbanë evidencë C.nr.437/2014 të datës;24.11.2017,ndërsa shuma prej;270.00 euro në emër të përfaqësimit në seancën e datës;24.05.2018 të të autorizuarës së palës paditëse si dhe shumën prej;208.00 euro në emër të pagesës së taksës për ankesë sipas këtij aktgjykimi.Gjykata në fund pasi që ka vlerësuar dhe ka analizuar të gjitha provat e cekura më lartë,duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi,është bazuar në dispozitën e nenit 262 dhe nenit 277 të LMD-së,si dhe në dispozitën e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

Ek.nr.181/2018 me dt;04.06.2018

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij,duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.